



UNMIK



IPVQ

INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

QEVERIA E KOSOVËS – GOVERNMENT OF KOSOVO – VLADA KOSOVA

MINISTRIA E ARSIMIT
SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

MINISTRY OF EDUCATION
SCIENCE & TECHNOLOGY

MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE
NAUKU I TEHNOLOGIJU

Kabineti i Ministrit

Cabinet of the Minister

Kabinet Ministra

UDHËZIM ADMINISTRATIV

Zbritja e tarifave që duhet të paguhen nga prindërit për më shumë se një fëmijë në institucionet parashkollore

NUMËR: 41/2007

DATË : 9.10. 2007

Në bazë të nenit 1.3 pika (d) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, nenit 25 paragrafi 7 i Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 1/2007, nenit 24.5 të Ligjit mbi Edukimin Parashkollor, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (më poshtë MASHT) nxjerr këtë Udhëzim administrativ:

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij Udhëzimi administrativ është që të ndihmohen familjet të cilat kanë një e më tepër fëmijë në institucionet parashkollore.

Neni 2

1. Në institucionet publike parashkollore ku fëmijët janë me qëndrim tërëditor, prindërit janë të obliguar të paguajnë 60 % të shpenzimeve të bëra, ndërsa 40% të shpenzimeve i heq komuna.
2. Paguesa bëhet në bazë të mesatares së të ardhurave në Kosovë.

Neni 3

Zbritja e tarifave

Zbritja e tarifave në shumën prej 60% që paguan prindi do të bëhet:

- a) Kur familja ka dy fëmijë në institucionin parashkollor do të paguajë, për njërin tarifën e plotë, ndërsa për të dytin 30 % më pak.
- b) Nëse familja ka 3 fëmijë në institucionin parashkollor, për të tretin do të paguajë 50 % të tarifës.
- c) Për çdo zbritje të tarifave kompensimin e bën DKA-ja.
- d) Nëse familja e ngushtë ka mbi dy studentë në shkollim, e gjithashtu ka edhe tre anëtarë të paaftë për punë, u zbritet tarifa prej 20%, praktikisht do të paguajnë vetëm 80%.

Neni 4

Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi me datën e nënshkrimit nga ministri.

Agim Veliu, ministër